

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7070
E enjte, 14 dhjetor 2023
Çmimi 0.50

Haxhi Shala nuk deklarohe për akuzat para Gjykatës Speciale

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (13) FAQE 4-5

A PATI 'KOMPLOT' KUNDËR LPK-së?

"Nuk bëhet fjalë për një Shtab të Përgjithshëm në kuptimin e drejtimit të forcave të armatosura, por për një strukturë që do ta ketë të drejtën të flasë në emër të forcave të armatosura"

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së katërbëdhjetë, ka folur rreth asaj nëse ka pasur "komplot" kundër LPK-së. Ai ka treguar se drejtues të Degës së LPK-së Jashtë Vendi në njërin nga mbledhjet e mbajtura në muajin mars 1994 vendosën që kompetencat e drejtimit të organizatës t'i kalonin kësaj dege të LPK-së. Sipas tij, që nga ajo kohë e deri në çlirimin e Kosovës strukturat e LPK-së brenda vendit u shndërruan në struktura të UÇK-së dhe nuk mund të konsolidoheshin njëkohësisht edhe si strukturë politike udhëheqëse. Në këtë intervistë Bardhyl Mahmuti ka folur edhe për komunikatat e lëshuara nga UÇK-ja. Ai thotë se të gjitha partitë politike dhe lëvizjet, marrë së bashku, nuk kanë mundur t'i mobilizojnë shqiptarët më shumë se sakrifica e Jasharëve



AKTUALE



OKB-JA KËRKON ARMËPUSHIM NË GAZË TEKSA RRIEN NDASITË MES SHBA-SË DHE IZRAELIT F. 2

HOVENIERI THOTË SE ËSHTË I HABITUR ME KRITIKAT QË PO BËHEN RRETH DRAFT-STATUTIT PËR ASOCIACIONIN F. 3

KEARNS DHE 12 ZYRTARË EVROPIANË KËRKOJNË HEQJEN E MASAVE TË BE-SË NDAJ KOSOVËS F. 7

EKONOMI



QEVERIA NDAN NGA 100 EURO PËR FËMIJËT DHE PENSIONISTËT F. 8

SPORT



SHALA NËNVLERËSON BALLKANIN: DINAMO ZAGREB DO TË KUALIFIKOHET F. 10



FLET PËR "EPOKËN E RE" ISH-MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME, PETRIT SELIMI

GJYKATA SPECIALE PO BËN CIRKUZ DUKE E DËMTUAR DREJTËSINË NË KOSOVË

F. 8-9

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Në Samitin për Klimën miratohet marrëveshja për shmangie të lëndëve djegëse të papërpunuara


DUBAI, 13 DHJETOR - Presidenca e Samitit global për Klimën COP28 e ka miratuar një marrëveshje për klimën, e cila për herë të parë i nxit shtetet që të bëjnë tranzicion prej lëndëve djegëse të papërpunuara, në mënyrë që të shmanget më e keqja në ndryshimet klimatike.

Marrëveshja reflekton një konsensus të gati 200 shteteve të mbledhura në Dubai, ndonëse shumë qeveri kanë insistuar në gjuhë më të ashpër, që nënkupton dhënien fund të përdorimit të lëndëve djegëse të papërpunuara, mirëpo diçka e tillë është

kundërshtuar prej vendeve prodhuese të naftës. “Kjo është hera e parë që bota bashkohet për një tekst që flet qartë për nevojën e tranzicionit nga lëndët djegëse të papërpunuara. Ka qenë problem i padiskutueshëm, që më në fund ka marrë vëmendje”, ka thënë ministri i Jashtëm norvegjez, Espen Barth Eide. Liderët e kanë miratuar dokumentin të mërkurën duke iu dhënë fund negociatave të vështira dyjavëshe. Marrëveshjet e arritura në samitet e Kombeve të Bashkuara duhet të miratohen me

konsensus, dhe më pas secili shtet është përgjegjës për zbatimin e tyre përmes politikave dhe investimeve kombëtare.

Synimi i kësaj marrëveshjeje është që deri më 2050 të mos ketë nxjerrje të dyoksidit të karbonit në natyrë prej këtyre lëndëve djegëse. Në të bëhet thirrje edhe për trefishim të kapacitetit për energji të ripërtërishme deri më 2030, që të rriten përpjekjet për ta zvogëluar përdorimin e thëngjillit dhe që të punohet drejt dekarbonimit të industrive. Kjo marrëveshje shënon herën e parë në dekada që



shtetet janë pajtuar për të hequr dorë gradualisht nga nafta, gazi dhe thëngjilli, përmes të cilave prodhohet rreth 80 për qind e energjisë në botë.

Shkencëtarët kanë thënë se këto lëndë djegëse përbëjnë burimin kryesor të emetimit të gazrave serrë, të cilat më pas ndikojnë në ndryshimet klimatike.

OKB-ja kërkon armëpushim në Gazë teksa rriten ndasitë mes ShBA-së dhe Izraelit

GAZA, 13 DHJETOR - Izraeli përballet me izolim diplomatik në rritje në luftën kundër Hamasit teksa Kombet e Bashkuara kanë kërkuar armëpushim humanitar të menjëhershëm në Gazë.

Hamasi, grup radikal që udhëheq Gazën me 2.4 milionë palestinezë, është shpallur organizatë terroriste prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian.

Presidenti amerikan Joe Biden i ka thënë të martën aletit të ngushtë të ShBA-së, Izraelit, se bombardimet pa dallim të civilëve janë duke dëmtuar mbështetjen ndërkombëtare.

Pas paralajmërimeve të disa zyrtarëve të OKB-së për thellim të krizës humanitare në Gazë, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e ka miratuar të martën një rezolutë që bën thirrje për armëpushim.

Në të mirë të rezolutës kanë votuar shumica e 193 vendeve anëtare. “Çmimi i mposhtjes së Hamasit nuk mund të përkthehet në vuajtje të vazhdueshme për të gjithë civilët palestinezë”, kanë thënë liderët e Kanadasë, Australisë dhe Zelandës së Re, përmes një deklarate ndaras që bënte thirrje për armëpushim.

Autoriteti palestinez e ka mirëpritur rezolutën dhe u ka bërë thirrje vendeve t'i bëjnë



presion Izraelit për ta respektuar dokumentin e miratuar.

Në zyrtar i Hamasit në ekzil, Izzat El-Reshiq, ka thënë përmes një deklarate në platformën “Telegram”, se Izraeli duhet t'i japë fund “agresionit, gjenocidit dhe spastrimit etnik të njerëzve tanë”.

Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli, të cilat besojnë se armëpushimi shkon vetëm në të mirë të Hamasit, kanë votuar kundër masës, bashkë me tetë shtete tjera.

Para miratimit të rezolutës, Bideni ka thënë se Izraeli tani e ka

mbështetjen e pjesës më të madhe të botës, përfshirë ShBA-në dhe Bashkimin Evropian, për ta luftuar Hamasin. “Mirëpo do të nisë ta humbë atë mbështetje për shkak të bombardimeve pa dallim që po ndodhin”, ka thënë ai prej Uashingtonit.

Një tjetër shenjë e dallimit në qëndrime ka qenë se Bideni ka thënë që kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu duhet ta ndryshojë qasjen e tij të ashpër qeveritare, dhe që në fund Izraeli “nuk mund t'i thotë jo” një shteti të pavarur palestinez - diçka që e kundërshtojnë izraelitët e linjës

së ashpër.

Këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, Jake Sullivan, do të udhëtojë këtë javë në Izrael, ndërsa sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, do ta vizitojë Lindjen e Mesme në javën tjetër. Biden dhe Sullivan do ta vënë në pah përkushtimin e ShBA-së ndaj Izraelit si dhe nevojën për mbrojtje të civilëve në Gazë.

Sulmet e Izraelit në Gazë, për ta çrrënjësuar Hamasin, kanë vrarë të paktën 18 205 palestinezë, përfshirë shumë fëmijë, dhe kanë plagosur rreth 50 000 të tjerë,

sipas autoriteteve shëndetësore të Gazës.

Konflikti ka rezultuar me uri të madhe, zhvendosje të 85 për qind të popullatës prej shtëpive të tyre dhe ka rritur mundësitë për përhapje të sëmundjeve, sipas OKB-së.

Izraeli e ka nisur luftën ndaj Hamasit pasi militantët e tij kanë vrarë 1 200 njerëz dhe kanë marrë 240 pengje në një sulm në jug të Izraelit më 7 tetor.

Rezoluta e OKB-së nuk është detyruese, mirëpo ka peshë politike, sepse reflekton qasjen e botës ndaj luftës.


Dhjetëra të plagosur nga sulmet me raketa në Kiev

Kiev, 13 dhjetor - Mbetjet e raketave ruse të rrëzuara prej mbrojtjes ajrore ukrainase kanë dëmtuar një spital dhe një ndërtesë banimi në kryeqytetin ukrainas Kiev, duke plagosur të paktën 50

persona, kanë thënë autoritetet e qytetit.

Sulmi ka ndodhur teksa presidenti i shtetit, Volodymyr Zelensky, ka qenë jashtë vendit, në një vizitë në Uashington, ku presidenti

amerikan Joe Biden ka paralajmëruar që Rusia po pret që Shtetet e Bashkuara ta braktisin Ukrainën. Kjo shifër përbën numrin më të madh të të plagosurve në Kiev në muajt e fundit.



Hovenieri thotë se është i habitur me kritikën që po bëhen rreth draft-statutit për Asociacionin

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të mërkurën se është i habitur me komentet dhe kritikën që janë duke u bërë për draft-statutin për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të propozuar prej zyrtarëve të lartë perëndimorë. "Mendoj se fokusi duhet të jetë se si mund të ecë Kosova përpara, duke e adoptuar këtë draft, nëse ka pyetje rreth kushtetutshmërisë, siç e kam thënë edhe më herët, po e them sërish, ekziston vetëm një trup që mund të vendosë se çfarë është në përputhje me Kushtetutën", ka thënë Hovenier, duke përmendur se vetëm Gjykata Kushtetuese mund të vendosë për kushtetutshmërinë e draftit të propozuar.

Ai i ka bërë këto deklarata pas një bashkëbisedimi me studentë në Mitrovicë. Hovenieri u ka thënë medieve

se qëndrimi amerikan nuk ka ndryshuar lidhur me Asociacionin: "ShBA-ja beson se është obligim për Kosovën ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. E di që natën e kaluar BE-ja dhe Këshilli i tij e kanë rikthësuar atë pritje, që Qeveria e Kosovës duhet të bëjë lëvizje në atë drejtim. Pozicioni i ShBA-së ka qenë i qartë. Asociacioni duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën aktuale të Kosovës, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Nuk duhet të jetë nivel i tretë pushteti. Nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive. Nuk e duam edhe një Republika Sërpska. Nuk duam diçka që ka ndikim negativ në funksionim të shtetit të Kosovës".

Hovenieri është pyetur edhe nëse mund të ndryshojë draftin i propozuar, ndonëse ai ka thënë se dokumenti në fjalë reflekton qëndrimin e Perëndimit. "Kjo është pyetje për [të dërguarin e BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav] Lajçakun. Mendoj se ai i ka thënë



Qeverisë së Kosovës dhe të tjerëve se është i hapur për komente. Mirëpo ekipi i Lajçakut, me mbështetje të ShBA-së, ka punuar nga afër në këtë draft për të garantuar se i përmbush të gjitha kushtet që i përmenda. A ka vend për përmirësime? Ndoshta! Por nuk duhet humbur kohë në specifika për të humbur momentumin, për të ecur

përpara me Asociacionin". Draft-statuti për Asociacionin u është paraqitur Prishtinës dhe Beogradit në tetor. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, kanë thënë se për ta është i pranueshëm. Gjërat nuk janë duke ecur përpara për shkak të kushtëzimeve të palëve. Në disa takime veç e veç me

zyrtarë perëndimorë, në tetor, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se nënshkrimi i marrëveshjeve me vendin fqinj garanton zbatimin e marrëveshjeve, ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka insistuar në zbatimin e "asaj që është nënshkruar". Ditët e fundit drafti u është dorëzuar edhe partive opozitare në Kosovë.

Haxhi Shala nuk deklarohet për akuzat para Gjykatës Speciale



Hagë, 13 dhjetor - Ish-eprori i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Haxhi Shala, të mërkurën ka bërë paraqitjen e tij të parë në Gjykatën Speciale në Hagë, në të cilën nuk është deklaruar rreth fajësisë apo pafajësisë së tij ndaj tri akuzave.

Prokuroria e Specializuar në Hagë e ngarkon Shalën me tri akuzat: tentativë për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, tentim për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në

veprimin e përbashkët të një grupi dhe për frikësim gjatë procedurës penale. "Nuk mund të deklarohem sot. E lë për seancën tjetër", ka thënë Shala pasi iu lexua aktakuza në seancën e mbajtur pasditen e 13 dhjetorit.

Brenda 30 ditësh Shala ka të drejtë ta pranojë fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, tha se do të ketë një seancë tjetër për deklarimin e Shalës si dhe do të caktohet data për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e

çështjes. Sipas gjykatës, aktakuza kundër Haxhi Shalës u konfirmua më 4 dhjetor 2023 nga gjykatësi i procedurës paraprake. Shala ka konfirmuar se e ka pranuar aktakuzën në gjuhën që ai e kupton.

Ai është arrestua më 11 dhjetor dhe një ditë më vonë është transferuar në Qendrën E paraburgimit në Hagë. Shalës i është caktuar një avokat mbrojtës kujdestar deri në emërimin e një mbrojtësi përfundimtar.

Sipas aktakuzës, në periudhën midis 5 dhe 12 prillit 2023, Shala,

bashkë me Sabit Januzin dhe Ismet Bahtjarin (të dy të akuzuar nga Specialja), kontaktuan një dëshmitar. Aktakuza thotë se ata, veçmas, takuan dëshmitarin, në dy raste, "për ta nxitur atë që ta tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi në proceset zyrtare para Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndër të cilat përmes kërcënimit të rëndë apo premtimit për përfitime". Kjo sjellje tregon se Shala synonte ta frikësonte dëshmitarin 1 dhe të pengonte persona zyrtarë, përfshirë prokurorë dhe hetues të Zyrës së

Prokurorit të Specializuar, në kryerjen e detyrave zyrtare, thuhet në aktakuzë.

Së fundi, Specialja e ka arrestuar edhe ish-kryetarin e Malishevës, Isni Kilaj, nën dyshimin për pengim të drejtësisë. Ndërkaq, në muajin tetor, janë arrestuar dhe transferuar në objektin e paraburgimit në Hagë edhe Sabit Januzi dhe Ismet Bahtjari, të cilët, sipas Speciales, akuzohen për "frikësim dhe tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përfshirë përmes kërcënimit të rëndë".

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (13)

A pati “komplot” kundër LPK-së?

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së katërmbëdhjetë, ka folur rreth asaj nëse ka pasur “komplot” kundër LPK-së. Ai ka treguar se drejtues të Degës së LPK-së Jashtë Vëndit në njërën nga mbledhjet e mbajtura në muajin mars 1994 vendosën që kompetencat e drejtimit të organizatës t’i kalonin kësaj dege të LPK-së. Sipas tij, që nga ajo kohë e deri në çlirimin e Kosovës, strukturat e LPK-së brenda vëndit u shndërruan në struktura të UÇK-së dhe nuk mund të konsolidoheshin njëkohësisht edhe si strukturë politike udhëheqëse. Në këtë intervistë Bardhyl Mahmuti ka theksuar se nuk është bërë asnjëherë fjalë për një Shtab të Përgjithshëm të UÇK-së në kuptimin e drejtimit të forcave të armatosura, por për një strukturë që do ta ketë të drejtën të flasë në emër të forcave të armatosura

PRISHTINË, 13 DHJETOR -

“Epoka e re”: Mendoj se ka nevojë të sqarohet lexuesi si qëndron puna e përfaqësimit të LPK-së në takimet me bartësit e institucioneve shtetërore të Shqipërisë. A përfaqësonte delegacioni juaj organizatën apo ishit vetëm kryesi e Degës së LPK-së Jashtë Vëndit?

Bardhyl Mahmuti: Edhe pse me statutin e LPK-së Dega Jashtë Vëndit kishte kompetenca të njëjta me një Këshill të Rrethit të LPK-së brenda vëndit, duke pasur parasysh pasojat e arrestimeve të njëpasnjëshme në të kaluarën, LPK-ja futi një normë statutare që në rast të pamundësisht të veprimtarisë së organeve drejtuese në Kosovë, kompetencat i barteshin Degës së saj Jashtë Vëndit.

Në fund të muajit korrik 1993 filloi një valë e madhe arrestimesh të anëtarëve të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), ndërkaq në javën e parë të muajit gusht u arrestuan Xhavit Haziri dhe Bajrush Xhemajli, anëtarë të kryesisë së re që ishte zgjedhur në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme të LPK-së, të mbajtur në Prishtinë më 26-27 korrik 1993. Për ta ndërprerë zinxhirin e arrestimeve të mundshme, dy anëtarë të tjerë të kryesisë (Halil Selimi dhe Adnan Asllani) dhe ish-udhëheqësi i LPK-së, Ramadan Avdiu, u larguan nga Kosova, ndërkaq Shaban Shala dhe Emin Krasniqi mbetën në

klandestinitet të thellë derisa u bindën se metodat e zbatuara gjatë hetimeve ndaj Xhavit Hazirit dhe Bajrush Xhemajlit nuk kishin arritur të zbulonin asgjë që lidhej me Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme të LPK-së.

Pas këtyre arrestimeve, drejtues të organizatës që ishin larguar nga Kosova dhe drejtues të Degës së LPK-së Jashtë Vëndit mbajtën mbledhje në Tiranë për ta analizuar situatën e krijuar. Në njërën nga mbledhjet që është mbajtur në muajin mars 1994 u vendos që kompetencat e drejtimit të organizatës t’i kalonin Degës së LPK-së. Që nga ajo kohë e deri në çlirimin e Kosovës strukturat e LPK-së brenda vëndit u shndërruan në struktura të UÇK-së dhe nuk mund të konsolidoheshin njëkohësisht edhe si strukturë politike udhëheqëse. Prandaj drejtuesit e Degës Jashtë Vëndit përfaqësonin politikisht tërë organizatën.

“Epoka e re”: A mund të thuhet se në përputhje me kompetencat që iu bartën Degës së LPK-së, kryesia e saj sollti vendim që tërësia e njëjësive të armatosura që vepronin nën udhëheqjen e LPK-së të emërohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës?

Bardhyl Mahmuti: E saktë. Mirëpo përveç këtij emërtimi, në mbledhjen e 17 nëntorit 1994 ishte vendosur që trupa komanduese të quhej “Shtabi



Qendror i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” dhe të fillohej me publikimin e komunikatave në emër të saj. Sipas pohimeve të Emrush Xhemajlit, sekretar i atëhershëm i LPK-së, komunikata e parë që është lëshuar në emër të “Shtabit Qendror të UÇK-së” të mbante numrin 11, për të përfshirë 11 aksionet që ishin kryer përpara se të fillohej me lëshimin e komunikatave.

“Epoka e re”: A keni qenë në dijeni se kush i shkruante këto komunikata?

Bardhyl Mahmuti: Jo, nuk kam qenë në dijeni. Për shkak të obligimeve të shumta që kisha gjatë studimeve në Universitetin e Lozanës, në vitin 1992 kam kërkuar të lirohem nga detyra e anëtarit të Kryesisë së LPK-së dhe veprimtarinë e kufizova kryesisht në kuadër të Këshillit

të rrethit ku jetoja. Për këtë arsye nuk e di as nga cili person janë marrë të dhënat, as për atë se kush i ka shkruar dhe as për vëndin nga ku janë lëshuar për publikim këto komunikata. Pas përfundimit të ciklit të tretë të studimeve (shkurt 1997) u angazhova tërësisht në aktivitetet e LPK-së. Në Mbledhjen e Gjashtë të Përgjithshme të LPK-së Dega Jashtë Vëndit, që u mbajt më 2 dhe 3 maj 1998, në Zell (rrethinë e Zurich-ut në Zvicër), u zgjodh Këshilli i ri i Përgjithshëm, ndërkaq në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm, të mbajtur më 6 qershor 1998 në Würzburg të Gjermanisë, u zgjodh Kryesia e re: Bedri Islami (kryetar), Jashar Salihu dhe Bardhyl Mahmuti (nënkryetarë), Sejdi Gega (përgjegjës financiar), Agush Buja (sekretar), Ali Ahmeti dhe Ibrahim Kelmendi

anëtarë të kryesisë.

Për këtë arsye nuk e di as nga cili person janë marrë të dhënat, as për atë se kush i ka shkruar dhe as për vëndin nga ku janë lëshuar për publikim këto komunikata.

“Epoka e re”: Kur bëhet fjalë për Mbledhjen e Gjashtë të Përgjithshme të LPK-së, jo rrallë dëgjohet termi “komplot” për të cilësuar moszgjedhjen e disa anëtarëve të kryesisë së moçme në kryesinë e re. Ku qëndron problemi?

Bardhyl Mahmuti: Ata që përdorin termin “komplot” për t’i përshkruar zhvillimet gjatë kësaj mbledhjeje të përgjithshme nuk e kuptojnë se në aspektin shkencor një organizim politik përkufizohet si hapësirë ku prapa pretendimeve të një strukture homogjene ka raporte forcash për të marrë në

duart e veta strukturën drejtuese. Divergjencat që lindën gjatë Mbledhjes së Gjashtë të Përgjithshme duhet të shihen nga ky këndvështrim. Ata që kanë menduar se mund të jenë gjithmonë në funksione drejtuese të organizatës sonë, nuk e kanë kuptuar parimin bazë të funksionimit të luftës politike.

T'i kthemi normës statutare të LPK-së, sipas së cilës, Dega Jashtë Vendit kishte kompetenca të njëjta me një Këshill të Rrethit të LPK-së brenda vendit. Megjithatë kryesia e Degës Jashtë Vendit kishte imponuar një rregull për anëtarët e LPK-së që largoheshin nga Kosova, pa marrë parasysh funksionet që kishin pasur brenda vendit, të sistemoreshin në kuadër të Këshillit Popullor të vendbanimeve ku i përcaktonin autoritetet e shteteve përkatëse ku vendoseshin si azilkërkues. Kjo rregullore pamundësonte që udhëheqësit e organizatës që vinin nga Kosova të përfshiheshin në drejtim të organeve drejtuese të Degës së saj, me arsyetim se organet drejtuese ishin zgjedhur në një mbledhje të përgjithshme! Sado paradoksale që ka qenë një rregull e tillë, askush nga udhëheqësit e LPK-së që braktisnin Kosovën për t'iu shmangur arrestimit nuk e ka cilësuar si "komplot" kundër udhëheqjes brenda vendit! Përkundrazi të gjithë kemi respektuar rregullat e kësaj mënyre të funksionimit. Dhe pikërisht ata që kishin krijuar një rregull të tillë, kur nuk u zgjodhën ta vazhdonin drejtimin e organizatës, filluan t'i akuzojnë të tjerët për "komplot".

"Epoka e re": A mund të merrni ndonjë shembull konkret kur drejtuesit e LPK-së kanë qenë të detyruar të largohen nga Kosova dhe të mos jenë përfshirë në organet drejtuese të Degës së saj Jashtë Vendit?

Bardhyl Mahmuti: Kjo ka ndodhur me të gjithë udhëheqësit e Lëvizjes, pa përjashtim. Po marr shembull Ramadan Avdiun, Halil Selimin dhe Adnan Asllanin që u larguan nga Kosova pas arrestimeve të vitit 1993. Bëhet fjalë për udhëheqës shumëvjeçarë të LPK-së në momentet më të vështira dhe më vendimtare për ardhmërinë e rezistencës sonë: ishin drejtues të organizatës që nga koha kur u vendosën themelet e rezistencës sonë të armatosur, së bashku me Afrim Zhitinë, Fadil Vatën, Fahri Fazliun etj.. Kur Dega Jashtë Vendit mori kompetenca të përfaqësonte tërë organizatën, asnjëri prej tyre nuk u kooptua në organet drejtuese edhe pse ata ishin zgjedhur drejtues të LPK-së në disa mbledhje të

përgjithshme të mbajtura brenda vendit, vendimet e të cilave nuk ishin pezulluar asnjëherë!

Është tepër domethënës qëndrimi i organeve drejtuese të Degës së LPK-së ndaj Halil Selimit dhe Ramadan Avdiut. Në kohën kur "pasuli numërohej kokërr për kokërr", siç thuhet në Kosovë kur rrethanat janë tepër të rënda, Halili dhe Ramadani gëzonin besimin e plotë ta drejtonin organizatën. Mirëpo kur dolën "jashtë vendit" dhe kur kompetencat iu bartën Degës, gjërat ndryshuan. Megjithëse Halil Selimi vendosi të qëndronte në Shqipëri, e jo të dilte në shtetet perëndimore si shumica prej nesh, ai asnjëherë nuk u emërua zyrtarisht përfaqësues i organizatës në shtetin shqiptar, përkundrazi asaj se ishte në kontakt të vazhdueshëm me veprimtarët në trojet e pushtuara shqiptare. Ndërsa Ramadan Avdiu nuk u zgjodh as anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Degës, e lëre më anëtar kryesisë! Përkundrazi kësaj, asnjëherë nuk i kemi dëgjuar të akuzojnë kryesinë e Degës për "komplot" ndaj udhëheqësve të organizatës!

Jam i sigurt se kryesia e atëhershme e Degës Jashtë Vendit do t'i trajtonte në mënyrë të njëjtë edhe Afrim Zhitinë, Fahri Fazliun, Xhavit Hazirin dhe të gjithë udhëheqësit e tjerë të organizatës që ranë në altar e lirisë, nëse do të kishin dalë jashtë Kosovës. Për këtë mënyrë të funksionimit, veprimtari i shquar i çështjes kombëtare, Mehmet Bislimi, thoshte me ironi: "Shumicën prej nesh do ta

kishin nderuar vetëm në bronz! Por fajet i ka Zoti që nuk na ka dhënë trimërinë e heronjve, madje as mjekrën si të Adem Jasharit!"

"Epoka e re": Jo vetëm në lidhje me kryesinë e LPK-së, por termi "komplot" ju vishet edhe në raport me UÇK-në? Përderisa nga komunikata që mban numrin 11, e datës 17 nëntor 1994, e deri te komunikata numër 46, e datës 16 mars 1998, të gjitha janë lëshuar në emër të Shtabit Qendror të UÇK-së, komunikata numër 47, e datës 12 maj 1998, dhe të gjitha komunikatat pas kësaj date janë lëshuar në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. A ke njohuri se si ndodhi një gjë e tillë?

Bardhyl Mahmuti: Është interesant se si arritën ithtarët e interpretimit të rrjedhave politike të asaj kohe nëpërmjet gjoja "komplotit" ta përqendrojnë vëmendjen te ndërrimi i emërimit të "organit komandues" të UÇK-së dhe të lënë në heshtje qëndrimet e turpshme të atyre që kishin shkruar dhe publikuar në emër të Shtabit Qendror të UÇK-së dy komunikatat paraprake. Në Komunikatën numër 45, të datës 9 mars 1998, dhe në komunikatën numër 46, të datës 16 mars 1998, nuk u shkrua asnjë fjalë e vetme për Epopenë e UÇK-së, rezistencën legjendare të familjes Jashari dhe krimin e gjenocidit në Prekaz!!!

Ju betohem që nuk e di se kush e ka shkruar komunikatën numër 47. As pas përfundimit të luftës

nuk kam qenë kureshtar të mësoj të vërtetën për këtë gjë. Mirëpo nëse quhet "komplot" veprimi që "udhëheqësve" të cilët përbuzën sakrificën e Jasharëve, t'u merrej e drejta për të publikuar komunikata në emër të UÇK-së, atëherë po e them publikisht: hallall u qoftë!

"Epoka e re": A mendoni se lënia në heshtje e Epopesë së UÇK-së u bë qëllimisht apo ka mundur të jetë për shkak të mungesës së informatave të sakta për atë që ndodhi në Prekaz?

Bardhyl Mahmuti: Jo, nuk ishte mungesë informatash! Rezistenca e familjes Jashari gjatë ditëve dhe netëve të 5, 6 dhe 7 marsit 1998, nga njëra anë, dhe barbaria serbe, nga ana tjetër, vunë në qendër të opinionit publik kombëtar dhe ndërkombëtar atë që ka marrë emrin Epope e UÇK-së.



Pa asnjë ngurrim mund të them se të gjitha partitë politike dhe lëvizjet marrë së bashku nuk kanë mundur t'i mobilizojnë shqiptarët më shumë se sakrifica e Jasharëve. Protestat që shpërthyen në të katër anët e botës ku kishte shqiptarë, ku u brohorit për UÇK-në dhe për pavarësinë e Kosovës, dëshmon më së miri se të gjithë kemi qenë të informuar shumë mirë për atë që ndodhi në Prekaz. Sa i përket ndikimit të kësaj sakrifice në skenën e politikës ndërkombëtare po citoj thëniet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovë, z. Bernard Kouchner (Kushner), gjatë vizitës në Kullë të Jasharëve në Prekaz: "Në emër

të Kombeve të Bashkuara dhe Misionit UNMIK që përfaqësoj, kam ardhur t'ju përshëndes dhe t'ju përcjell njëkohësisht mbështetjen dhe admirimin tonë për ju dhe familjen tuaj, sepse bota reagoi pikërisht për shkak se disa nga prej jush ranë dëshmorë, në mesin e të cilëve pati shumë anëtarë të familjes suaj. Dhe pikërisht për arsye se këtu, në Prekaz, ndodhën këto sakrifica, bota filloi të lëvizë, dhe Prekazi vetëdijësoi botën për realitetin, për sakrificat dhe për luftimet. Për këtë arsye, nëse do të kishte çmim Nobel për liri, familja juaj do të duhej ta merrte!"

Të lëshosh një komunikatë në emër të UÇK-së më 9 mars 1998 dhe të pretendosh se "konfrontimi i forcave tona të armatosura me formacionet e forcave pushtuese ushtarake e policore serbe ka filluar më 7 mars 1998 (sic!) prej Gillogovcit në drejtim të Skenderajt, në veri në drejtim të Klinës, në lindje deri në Mitrovicë, kah fshatrat e Çiçavicës, nga Gillogovci në drejtim të Prishtinës... në Krahinën e Llapit, në territorin ndërmjet Deçanit, Gjakovës dhe Klinës, Malishevës, e Rahovecit, duke kaluar nga hapësira e Lumëthatit... dhe në vijën nga Deçani në drejtim të Pejës" pa përmendur luftimet në Prekaz, nuk është mungesë informatash, por heshtje e qëllimshme!

"Epoka e re": Domethënë ju jeni të bindur se një heshtje e tillë ishte e qëllimshme?

Bardhyl Mahmuti: Të lëshosh për opinionin publik dy



komunikatat e mësipërme në emër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ta heshtësh ngjarjen që bëri kthesë të jashtëzakonshme në historinë tonë kombëtare nuk është e rastësishme! U takon atyre që çirren për gjoja “komplotin” që është bërë në Mbledhjen e Gjashtë të Përgjithshme, të sqarojnë publikisht se kush i shkroi këto dy komunikata dhe përse u hesht heroizmi dhe tragjedia e familjes Jashari.

“Epoka e re”: Në Komunikatën 47 që u lëshua në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së përmendet rënia heroike e një numri luftëtarësh të cilët nuk ishin përmendur fare në komunikatat paraprake. Në mesin e këtyre emrave janë edhe Adem Jashari, Hamëz Jashari, Shaban Jashari, Osman Geci e deri tek Ilir Konoshevc. Si e interpretoni këtë formë të re të komunikimit?

Bardhyl Mahmuti: Vërtet nuk e di saktësisht se çfarë i ka shtyrë shkruarit e kësaj komunikate të ndryshojnë në krahasim me format e mëparshme të komunikatave, mirëpo sa i përket përfshirjes së emrave të disa personaliteteve të rezistencës sonë në komunikatën e lëshuar pas më



shumë se dy muajsh nga koha kur kishin ndodhur vrasjet e tyre, mendoj se ishte një përpjekje për t'i përmirësuar gabimet e atyre që nuk e di për çfarë motivesh ishin përpjekur t'i lënë në heshtje!

“Epoka e re”: Pas cilësimit të rënies së Jasharëve si rënie

heroike, Adem Jasharit iu dha epiteti Komandant Legjendar i UÇK-së. Edhe ju e quajtet rezistencë legjendare qëndresën e familjes Jashari. Si lindi ideja për ta përdorur epitetin “legjendar”?

Bardhyl Mahmuti: Kryetari i LPK-së, Bedri Islami, ishte nismëtar i idesë që t'i jepej

epiteti komandant legjendar Adem Jasharit. Më konkretisht, ideja fillestare e tij ishte për emërtimin Komandant i Përgjithshëm Legjendar, sepse me trimërinë e pashoqe që kishte treguar në të gjitha aksionet kundër pushtuesve serbë dhe me rezistencën e jashtëzakonshme që dëshmoi përpara opinionit publik kombëtar dhe ndërkombëtar gjatë 5, 6 dhe 7 marsit 1998, Adem Jashari i dha karakter legjendar historisë sonë moderne. Ideja e tij u përqafua nga shumica e anëtarëve të Kryesisë së LPK-së dhe veprimtarëve me të cilët ishte konsultuar dhe, në fund, në emër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari u shpall Komandant Legjendar.

“Epoka e re”: A pati ndonjë ndryshim organizativ cilësor që ndikoi në ndryshimin e emrit nga Shtab Qendror në Shtab të Përgjithshëm?

Bardhyl Mahmuti: Ndryshimi i emrit nga Shtab Qendror në Shtab të Përgjithshëm nuk ka të bëjë me aspektet komanduese të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Si në rastin e Shtabit Qendror, kur komunikatat janë lëshuar nga Kryesia e LPK-së, edhe në rastin e Shtabit të Përgjithshëm, kur komunikatat nuk shkruheshin nga kryesia e re e LPK-së, por nga nuk e di se kush në Kosovë, nuk kemi një organ drejtues të operacioneve ushtarake, por bëhet fjalë për qendër të orientimit propagandistik. Për dallim nga periudha kur njësitë e armatosura të UÇK-së ishin numerikisht të pakta dhe në emër të saj “fliste” vetëm Shtabi Qendror, “në kohën e Shtabit të Përgjithshëm” shtrirja e luftës së armatosur kishte marrë karakter të përgjithshëm

kombëtar dhe, përveç komunikatave që lëshoheshin në emër të Shtabit të Përgjithshëm, vazhdimisht kemi pasur publikimin e komunikatave të Zonave Operative, deklarata të zëdhënësve të këtyre zonave e kështu me radhë. Me një fjalë, asnjëherë nuk arritëm të kemi një shtab të vetëm propagandistik që do të “fliste” në emër të tërësisë së forcave të armatosura.

“Nuk bëhet fjalë për një Shtab të Përgjithshëm në kuptimin e drejtimit të forcave të armatosura, por për një strukturë që do ta ketë të drejtën të flasë në emër të forcave të armatosura”

“Epoka e re”: Domethënë ju pajtoheni me ata që vazhdimisht kanë mohuar ekzistencën e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

Bardhyl Mahmuti: Po e përsëris: nuk bëhet fjalë për një Shtab të Përgjithshëm në kuptimin e drejtimit të forcave të armatosura, por për një strukturë që do ta ketë të drejtën të flasë në emër të forcave të armatosura. Dihet botërisht se gjatë luftës, Komandanti i Përgjithshëm i UÇK-së, Azem Syla, ka qëndruar shumë pak në Kosovë. E njëjta gjë vlen edhe për një numër të konsiderueshëm anëtarësh të Shtabit të Përgjithshëm. Shumica e atyre që gjatë luftës së armatosur në Kosovë mohonin ekzistencën e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ishin pikërisht veprimtarë të cilët përpiqeshin t'i merrnin kompetencat të “flisnin” në emër të forcave të armatosura, jo t'i drejtonin operacionet ushtarake!

Të jemi të qartë! Për asnjë çast nuk ka munguar dëshira për të pasur një strukturë komanduese që do t'i drejtonte të gjitha operacionet luftarake. Madje do të donim të kishim një strukturë edhe më të përkryer se strukturat komanduese të shteteve anëtare të NATO-s. Objektivist një gjë e tillë ishte e pamundur për shkak të pranisë së forcave të shumta të armatosura serbe në Kosovë dhe mjeteve të sofistikuar që posedonin për t'i përgjuar komunikimet tona.

(Muhamet MAVRAJ / Vijon)



Qeveria ndan nga 100 euro për fëmijët dhe pensionistët

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të ndajë nga 100 euro për të gjithë fëmijët nën 16 vjeç në muajin dhjetor.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se pushteti synon që vitin e ardhshëm ta avancojë skemën, sipas parimit që ata që kanë më pak të ardhura, të përfitojnë më shumë.

Deri më tani qeveria ka ndarë nga 10 euro për fëmijët nën moshën 16 vjeç dhe nga 20 euro për fëmijët deri në dy vjeç.

Kurti është zotuar se në të ardhmen fëmijët do të përfitojnë nga shtesat prej 50

deri 150 euro.

Në mbledhjen e parafundit të qeverisë, Kurti ka thënë se këtë muaj edhe pensionistët do të përfitojnë nga 100 euro, përveç pensionit të rregullt.

Pensionet në Kosovë dallojnë nga 100 deri në 265 euro, varësisht prej kontributit.

Nga janari e deri në korrik të këtij vit, Kosova ka shpenzuar mbi 305 milionë euro në përkrahje financiare për personat e pensionuar dhe për ata që janë në skema të ndryshme sociale.

Buxheti i paraparë i Kosovës për vitin e ardhshëm pritet të jetë 3.3 miliardë euro në krahasim

me 3.2 miliardë euro sa ishte këtë vit.

Ndër vendimet e tjera, Kurti ka thënë se buxhetit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) i janë shtuar edhe 40 milionë euro, dhe se buxheti i ndarë në mbrojtje këtë vit tejkalon shifrën 200 milionë euro.

Forca e Sigurisë e Kosovës është në proces të transformimit në Ushtri.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjet për këtë transformim në vitin 2018.

Përgjegjësitë e reja të FSK-së, mes të tjerash, kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës,



si dhe të qytetarëve, pronave dhe interesave të vendit.

Aktualisht, FSK-ja ka rreth 2 500 pjesëtarë. Pas periudhës së

tranzicionit, ky numër pritet të rritet mbi 7 500 dhe t'i përfshijë pjesëtarët aktivë dhe ata rezervistë.

Kearns dhe 12 zyrtarë evropianë kërkojnë heqjen e masave të BE-së ndaj Kosovës

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Deputetja britanike Alicia Kearns ka kërkuar nga Bashkimi Evropian që t'u japë fund të gjitha masave kundër Kosovës dhe të bëhet hetim i plotë për sulmin në Banjskë të Zveçanit. Në një letër të publikuar më 13 dhjetor në platformën "X", të njohur më parë si "Twitter", Kearns dhe 12 kryetarë të komiteteve të Parlamentit Evropian kanë kërkuar që BE-ja ta rikthejë bashkëpunimin e plotë me Qeverinë e Kosovës.

"Bojkotimi i zgjedhjeve komunale në krye me Listën Serbe, më 23 prill, sulmi ndaj KFOR-it më 29 maj, ndalimi arbitrar i zyrtarëve të Policisë së Kosovës nga autoritetet serbe më 14 qershor, dhe sulmet në Banjskë më 24 shtator, shpërfaqin një formë agresioni, me qëllim të destabilizimit të Kosovës", është thënë në letërën e nënshkruar prej Kearnsit dhe zyrtarëve të tjerë evropianë.

BE-ja pati marrë masa ndëshkuese ndaj Kosovës me arsyetimin se ky vend nuk i ka përmbushur kërkesat e BE-së për



shtesnionim të situatës.

Në mesin e masave ka qenë pezullimi i përkohshëm i punës për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit si dhe është pezulluar prania e Kosovës në organizimet e nivelit të lartë dhe vizitat bilaterale.

Në një takim të zhvilluar më 12 dhjetor nga ministrat e Bashkimit Evropian është thënë se BE-ja ka gatishmëri në heqjen e masave në rast se do të ketë përparim në përmbushjen e kërkesave. "Këshilli

mirëpret ndërmarrjen e hapave drejt zbatimit të disa kërkesave të BE-së. Këshilli rikujton se BE-ja mbetet e gatshme t'i heqë masat në rast të progresit të mëtijmë për përmbushjen e kërkesave ekzistuese".

Angazhimi i Kosovës në dialogun me Serbinë, që ndërmjetëson BE-ja, është përmendur si një prej tyre.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka falënderuar

deputeten britanike dhe zyrtarët e tjerë evropianë për mbështetjen dhe ka përsëritur se "masat e padrejta" kundër Kosovës duhet të hiqen.

Kearns ka kërkuar hetim të plotë dhe publikim të rezultateve për sulmin në Banjskë, me arsyetimin se situata ka rrezikuar të përshkallëzohet edhe më gjerë.

Më 24 shtator Policia e Kosovës është sulmuar në Banjskë të Zveçanit nga një grup i armatosur

serb. Për pasojë ka mbetur i vdekur zyrtari i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku. Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkryetari i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë.

Këtë muaj Agjencia Ndërkombëtare e Policisë (INTERPOL) ka lëshuar fletarrestim për të. Fletarrestimi për Radoičiqin është lëshuar në dhjetor me ndërmjetësimin e misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, në bazë të kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës.

Megjithatë, Megjithatë, gjykata në Beograd e ka liruar nga paraburgimi dhe ia ka konfiskuar dokumentet.

Hill: Serbët ta kuptojnë se fati i tyre është në duart e tyre, jo në Uashington, Bruksel dhe Pekin

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Serbi, Christopher Hill, tha më 13 dhjetor se "serbët duhet të kuptojnë se fati i tyre është në duart e tyre, jo në Uashington, Bruksel dhe Pekin".

Në hapjen e konferencës "Bota më 2024" në Beograd, ai theksoi se viti 2024 do të jetë "kompleks" dhe se rezultati i tij "do të varet nga shumë faktorë". "Viti i ardhshëm do të jetë shumë - shumë i rëndësishëm për të gjithë ata që duan ta shohin zgjerimin e mëtejshëm të Bashkimit Evropian (BE) dhe Serbisë në një vend tjetër", tha

Hill.

Ai shtoi se po "vëzhgon vullnetin e mirë" në Bruksel.

Serbia u bë kandidat për anëtarësim në BE në mars të vitit 2012. Ajo sot ende e ka atë status dhe negociatat e pranimit u hapën zyrtarisht në janar të vitit 2014.

BE-ja paralajmëron rregullisht se shpejtësia e procesit të anëtarësimit me Serbinë do të varet nga përparimi në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, i cili po zhvillohet nën lehtësimin e Bashkimit Evropian në Bruksel. Hill tha gjithashtu se "ka mundësi që dialogu ndërmjet Beogradit

dhe Prishtinës të përparojë në muajt në vijim dhe se në këtë kuptim ai beson se viti i ardhshëm do të jetë i rëndësishëm për Serbinë".

Më 27 shkurt 2023 Serbia dhe Kosova arritën një marrëveshje për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve.

Për Aneksin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje palët ranë dakord në Ohër më 18 mars.

Prishtina dhe Beogradi nuk e nënshkruan marrëveshjen apo Aneksin e zbatimit të saj sepse presidenti serb, Aleksandar Vučić, refuzoi të nënshkruante. Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008, të cilën Serbia nuk e njeh.



FLET PËR “EPOKËN E RE” ISH-MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME, PETRIT SELIMI

Gjykata Speciale po bën cirkuz duke e dëmtuar drejtësinë në Kosovë



Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Petrit Selimi, në një intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ka folur për zhvillimet e fundit në Kosovë, për dialogun me Serbinë, për diplomacinë e Kosovës, për opozitën dhe për zhvillimet e fundit në Gjykatën Special. Selimi ka theksuar se Kosova sot është vendi i vetëm në tërë Evropën, pas Rusisë dhe Bjellorusisë, që ka sanksione nga Perëndimi. Ai thotë se qeveria Kurti nuk ka strategji. “U prishëm me Amerikë. U prishëm me BE-në. U prishëm me Shqipërinë dhe humbëm shumë kohë”, thotë ai. Ish-ministri i Jashtëm ka thënë se ambasadat tona dhe diplomacia jonë është krejtësisht e izoluar dhe ka humbur ndikimin në Uashington dhe Bruksel. Duke folur për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, Selimi tha se kjo qeveri pranoi një status sekret të asociacionit. E për Gjykatën Speciale ka thënë se është duke bërë cirkuz. “Ky vit ishte vit i vështirë, por kam frikë që viti i ardhshëm do të ketë edhe më shumë vështirësi”, ka thënë Selimi

të mbyllur tash e tri vjet me vizitorë, asgjë më shumë. Pse s’po i botojnë edhe transkriptimet e prokurorisë me ofertat joshëse për dëshmitarë, apo edhe rastet ku është dëshmuar pa asnjë dyshim se dëshmitarët kanë qenë të ndikuar dhe paguar nga shërbimet serbe. Cirkuz total, por aspak qesharak.

“Epoka e r”: Disa zëra, përfshi edhe vetë kryeministrin Kurti, thonë se faj kanë Thaçi dhe të tjerët, sepse themelimi i saj u bë nga vetë këta liderë që sot po gjykohen.

Selimi: Themelimi i Gjykatës Speciale nuk ishte akt i veçantë, por një proces, ku Perëndimi, e sidomos administrata e presidentit Obama, solli dy opsione para Kosovës: ose Kosova ta themelojë në kuadër të Kushtetutës së vet këtë institucion që të pastrohet UÇK-ja nga akuzat për tregti organesh ose këtë tribunal do ta themelonte OKB-ja nën mandatin e Rezolutës 1244, që do ta kthente Kosovën në një protektorat, së paku në sundimin e ligjit. Presidenti Thaçi dhe shumica absolute e Kuvendit të Kosovës, edhe pse dihej se çmimi mund

të jetë i lartë dhe të përfundojë me arrestime të liderëve të UÇK-së, e bënë këtë sakrificë për hir të Kosovës. Këso sakrificë nuk e kemi parë nga lidershipi i tashëm të bëjë ndonjëherë, prandaj kritikon lehtë.

A ka gabuar Kuvendi që e ka votuar këtë gjykatë asokohe? Nga prizmi i sotshëm edhe mund të jetë ashtu, tani kur po shohim neglizhencën procedurale, tradhtinë morale dhe vitet e shkuara për të burgosurit që qëndruan të pafajshëm pa asnjë ditë gjykimi për ca vite në burg, si dhe narrativen e prokurorit krejtësisht të bazuar në teoritë serbe të luftës së Kosovës. Por vlerësimi për vendimet nuk mund të bëhet me kandin e gjërave që i dimë sot, por me ato që ishin para 10 viteve. Por duhet të jemi kritikë për degradimin e idesë fillestare për pastrimin nga akuzat e rrejshme të organeve, në një himerë të përcudnuar të përndjekjes politike dhe proceseve kuazi-ligjore, dhe të kërkojmë nga vetë gjykata dhe aleatët përgjegjësi dhe strategji dalëse nga ky cirkuz joqesharak që po dëmton drejtësinë në Kosovë.

**EPOKA
ERE****Sadik ZEQRIRI**

PRISHTINË, 13 DHJETOR -

“Epoka e re”: Z. Selimi, këto ditë keni pasur disa reagime në rrjetin social “X” (ish-Twitter) për ngjarjet në Hagë, përfshirë bastisjet që u janë bërë gazetarëve dhe bashkëpunëtorëve të presidentit Thaçi. E keni kritikuar Gjykatën Speciale. Mendoni se këto bastisje kanë premisa politike?

Selimi: Bastisjet kanë qenë

shumë të çuditshme, thënë butë. Për shembull, është absolutisht neveritëse kur një intelektual dhe aktivist politik si Blerim Shala, autor, shkrimtar, gazetar dhe pjesëmarrës aktiv në të gjitha proceset politike kyçe të Kosovës që nga 1980-ta e deri më sot, kur po këshillon edhe qeverinë Kurti për procesin e dialogut si konsulent i qeverisë norvegjeze, edhe atij i konfiskohet telefoni. A mendon dikush seriozisht se Blerim

Shala po frikësuaka dëshmitarë? Apo Ismail Sylja, një këshilltar i presidentit Thaçi që është edhe shkrimtar edhe poet, e që ka kaluar vite si i burgosur politik i diktaturës komuniste, si është e mundur që prokurorët specialë t’i hyjnë në shtëpi tërë ditën? Përgjimet që u përdorën nga gjykata si justifikim janë, po ashtu, neveritëse dhe rrezikojnë të drejtat e të akuzuarve. Biseda të lira për proces nga të akuzuarit që janë



“Epoka e re”: Shkuarja e liderëve të UÇK-së në Hagë është përputhur me ardhjen e qeverisë së re, përkatësisht dy qeverive Kurti I dhe Kurti II. Si e vlerësoni situatën sot sa i përket pozitës diplomatike të Kosovës?

Selimi: Kosova ka humbur goxha kohë këto vitet e fundit. Bota po ndryshon dramatikisht, me konflikte të mëdha dhe ndeshje midis shteteve por, ndoshta, edhe qytetërimeve. Ne ishim në një rrugëtim që t'i përmbylim kapitujt e hapur të Kosovës në marrëdhëniet tona me Serbinë - proces që Serbia absolutisht dëshironte ta vononte, ta mbante status quon dhe, fatkeqësisht, në vitet e fundit disa arritën t'ia plotësojnë dëshirën në një farë mënyre Serbisë.

U prishëm me Amerikë. U prishëm me BE-në. U prishëm me Shqipërinë dhe humbëm shumë kohë. Mos të harrojmë, Kosova sot është vendi i vetëm në tërë Evropën, pas Rusisë dhe Bjellorusisë, që ka sanksione nga Perëndimi. FSK-ja ishte përjashtuar nga ushtrimet ushtarake të NATO-s. Ambasadat tona dhe diplomacia jonë është krejtësisht e izoluar dhe ka humbur ndikim në Uashington dhe Bruksel. Këto janë fakte empirike e jo opinione subjektive.

Fare në fund qeveria pranoi, në “aksham pazar”, një status sekret të asociacionit, të “Zajednicës” së famshme për të cilën kur ishte në opozitë derdhi gjak, përdori dhunë, hodhi bomba dhe granata dhe shpalli tradhtarë majtas e djathtas.

“Epoka e re”: Besoni se qeveria po gabon që po pranon asociacionin?

Selimi: Asociacioni, apo e drejta e komunave të lidhen horizontalisht në procese joekzekutive ishte edhe në raportin e Kai Eides më 2006 edhe në Planin e Ahtisarit. Pra të krijosh një asociacion nuk është diçka që ne e pranojmë apo nuk pranojmë sepse është e drejtë kushtetuese e komunave. Koncepti i ndërtuar gjatë qeverive të shkuara, i përkrahur plotësisht me shkrim nga aleatët tanë, ishte që një asociacion konform Kushtetutës së Kosovës të krijohet si element në arritjen e marrëveshjes finale, ligjërish të obligueshme, me qendër njohjen e dyanshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. Por ne humbëm shumë kohë këto vitet e fundit dhe e lejuam që konteksti gjeopolitik të sforcjojë zbutje të qëndrimit të aleatëve dhe tani kjo qeveri është gati ta pranojë një asociacion pa njohje dhe pa ndonjë sinjal të qartë se kur do të arrihet marrëveshja finale ligjërish të obligueshme. Kjo marrëveshje nuk është finale, duhet të thuhet qartë. Kjo marrëveshje



po e lejon vazhdimin pa fund të negociatave.

Ndërsa ekziston edhe një aspekt i rëndësishëm i përgjegjësive politike, ndoshta edhe morale. A nuk ishte Kosova dhe liderët kosovarë nën presion të dhunës, të gazit lotsjellës, të koktejeve molotov, të granatave të hedhura nëpër oborre dhe automjete të djegura private të ministrave mu për shkak të “zajednicës”. Ku është përgjegjësia politike për gjakun e derdhur në rrugët e Kosovës nëse tani po pranohet e njëjta formulë, me shumë më pak përfitime për Kosovën?

“Epoka e re”: E cili pra qenka opsioni i opozitës? Në Kuvend kemi zëra të larmishëm, nga ish-kryeministri Haradinaj që aprovon këtë marrëveshje të fundit në Bruksel, deri te deputetë të PDK-së që

kundërshtojnë, si dhe të LDK-së që kritikojnë këtë marrëveshje. A nuk do të duhej opozita të flasë me një zë?

Selimi: Fillimisht të them se nuk mund të përgjigjem në asnjë formë në emër të opozitës sepse nuk jam as në organe as në pozitë ta quaj veten përfaqësues të opozitës apo edhe PDK-së. Jam qytetar i thjeshtë, me pak përvojë modeste nga 7 vjet të kaluara në diplomaci, dhe shumë më shumë vite të tjera në media dhe shoqëri civile.

Dhe absolutisht mendoj se qeveria meriton të kritikohet për jokonsistencë. Qeveritë e kaluara e kanë pranuar asociacionin dhe sot kritika ndaj Kurtit nuk është për pranin apo jo, por për degradim të procesit, vonesë të jashtëzakonshme, për gjakun e derdhur në rrugë në vitet e shkuara, për mungesë të qartë

të përfitimeve diplomatike për Kosovën. Një “zajednicë” që sjell probleme, por nuk solli njohjen e as ndonjë përfitim diplomatik të qartë.

Pra qeveria Kurti ka faj për mungesë totale të strategjisë qeverisëse. Dhe jo vetëm në dialog. Kush e di sot se çka bën ministrja e Arsimit, apo ai i Shëndetësisë, apo e ekonomisë? Janë zhdukur fare. Të padukshëm. Të pa-zë. Me ekonomi të dërrmuar nga kriza e koston së jetesës dhe me dështime në lëvrim të investimeve nga jashtë dhe ekzekutim të investimeve të brendshme. Këto janë të gjitha të verifikueshme. Suficiti nga keqmenaxhimi i buxhetit arrin 700-800 milionë euro. Komunitat opozitare nuk marrin investime kapitale nga qendra. Një shkapërderdhje totale e qeverisjes, por opozita nuk është se ka kapitalizuar në këtë

jokompetencë evidente të qeverisë. Vërehet një qetësi e padurueshme e opozitës, sidomos kur ka arsye të krenohet me të arriturat e pasluftës dhe sidomos pas pavarësisë.

“Epoka e re”: Fare në fund, çfarë e pret Kosovën në vitin 2024?

Selimi: Ky vit ishte vit i vështirë, por kam frikë që viti i ardhshëm do të ketë edhe më shumë vështirësi. Nuk shoh se ka ndonjë synim të qartë strategjik të lëvizim hovshëm përpara ndërsa edhe aleatët tanë janë të fokusuar në shumë vatra krizash. Do të kemi edhe zgjedhje në Amerikë dhe Bashkim Evropian, gjë që do të ngadalësojë zhvillimet edhe këndeje. Inshallah jemi gabim, por status quoja duket se është gjendje e kënaqshme për qeverinë tonë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kuka: Presim medalje nga Evropiani i xhudos në Prishtinë

PEJË, 13 DHJETOR - Kanë mbetur edhe tri ditë deri të zhvillimi i ngjarjes më të madhe sportive të deritanishme në vend, ku xhudistë elitari nga mbarë bota do të zbarkojnë në Prishtinë. Më 16 dhjetor (e shtunë) do të zhvillohen finalët e Kampionatit Evropian të xhudos

“Prishtina 2023”. Trajneri i ekipit kosovar të xhudos, Driton Kuka ka thënë për “KosovaPress” se përgatitjet për këtë Evropian kanë shkuar mirë, ndërsa beson se edhe nga kjo garë do të ketë medalje për Kosovën. “Përgatitjet kanë shkuar mirë, po besoj shumë që edhe nga kjo garë të kemi

medalje për Kosovën. Ky është caku. Në kategorinë e meshkujve po zbresin më të mirët e Botë, njëjtë edhe te femrat”, ka thënë Kuka. Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Akil Gjakova e Dardan Cena do të ndeshën për herë të parë në Kampionat Evropian në shtëpinë e tyre, në Kosovë.



Shala nënvlerëson Ballkanin: Dinamo Zagreb do të kualifikohet



ZAGREB, 13 DHJETOR - Ndeshja e Dinamo Zagrebit kundër kampionit kosovar Ballkanit do të zhvillohet këtë të enjte në “Maksimir” të Zagrebit. Për këtë takim ka folur ish-futbollisti i Prishtinës dhe Dinamo Zagrebit, Kujtim Shala, i cili favorizoi ish-ekipin e tij kroat duke thënë që Dinamo ka lojtarë të mirë dhe se “nuk shoh mënyrë se si mund t’i ndalojë Ballkani”. “Nuk duhet të nënçmohet askush, pra as Ballkani, por unë jam 100 për qind i sigurt që Dinamo do të fitojë në ndeshjen e kthimit. Nuk bëhet fjalë për ndonjë rezultat tjetër. Besoj në lojtarët tanë dhe në trajnerin Jokiroviq,

që sigurisht në mënyrë optimale do ta përgatit ekipin, do ta mposht Ballkanin dhe do të kalojnë në fazën tjetër të Ligës së Konferencës. Dinamo ka ekip më të mirë dhe do të festojë në ‘Maksimirin’ e stërbushur”, ka thënë Shala për gazetën kroate “Sportske Novosti”. Tutje, ai jep edhe instruksione se si duhet të luajë Dinamo duke treguar që të ketë një fillim të fuqishëm duke bërë presion në 15 minutat e parë e të shënojë gol. “Nuk duhet të pritët me durim, por menjëherë të sulmohet, të shënohet gol dhe të merret kontrolli në lojë. Ky është mendimi im. Jokiroviqi është trajner dhe ai vendos, por do të

thosha që mendojmë në mënyrë të ngjashme dhe që vërtetë do të kërkoj gol të hershëm”, ka shtuar Shala, që vazhdon të ketë shumë përkrahës në Kroaci. Ai konsiderohet legjendë e Dinamos. Sipas tij, Dinamo ka kualitet të padiskutueshëm që të fitojë kundër Ballkanit. Dinamo e Ballkani do të përballen të enjten prej orës 21:00 në “Maksimir” të Zagrebit, në kuadër të xhiros së fundit të fazës grupore të Ligës së Konferencës. Derisa Dinamos i mjafton barazimi për të avancuar, Ballkanit i duhet fitorja dhe në të njëjtën kohë që Astana mos të fitojë ndaj Viktoria Plzenit në Çeki.

Votohet projektligji për sport, synohen reforma të thella në këtë fushë

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të radhës ka votuar projektligjin e ri për sport. Me këtë rast, zëvendësministrja e Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport, Daulina Osmani ka thënë se ky projektligj synon reforma të

thella në sportin vendor. Ajo bëri të ditur gjithashtu se veçantia e këtij projektligji është se i trajton edhe ish-sportistët dhe trajnerët që kanë kontribuar në kohën e okupimit. “E veçantë e saj është që në kuadër të ligjit po ashtu adresohen edhe të drejtat e ish-

sportistëve, trajnerëve të cilët kanë dhënë kontributin e tyre gjatë kohës së okupimit. Përmes kësaj reforme po synojmë që sportin ta shndërrojmë në sektor me ndikim e impakt direkt në zhvillimin e përgjithshëm të vendit”, ka theksuar Osmani.



Dështojnë dy miqësoret e planifikuara për mars, FShF-ja në kërkim të rivalëve të rinj



TIRANË, 13 DHJETOR - Dëshira e trajnerit Silvinjo është që të përballemi me një kombëtare të fortë, pasi edhe në grupin e Evropianit, kundërshtarët janë të një niveli të lartë. Kështu braziliani do që të provojë paraprakisht kuqezinjtë ndaj një niveli më lart. Në ditët e fundit janë përfolur Zvicra dhe Turqia si kundërshtarë të mundshëm për ndeshje miqësore, por

“PanoramaSport” raporton se Shqipëria nuk do të përballët me Zvicrën apo Turqinë, të paktën deri tani, kjo edhe për shkak se të dyja kombëtares kanë pasur programet e tyre dhe ndoshta edhe ato kërkojnë një rival edhe më të fortë. Të gjithë duan të luajnë me skuadra të nivelit shumë të lartë dhe të provojnë veten se në çfarë gjendje janë. Kështu që

momentalisht çdo gjë është në pritje dhe FShF është në bisedime me kombëtare të tjera. Kujtojmë që Shqipëria do të përballët më 15 qershor në Dortmund me Italinë, 19 qershor në Hamburg me Kroacinë dhe 24 qershor në Dyseldorf kundër Spanjës. Kombëtarja do të zhvendoset te kampi stërvitor në Gjermani një javë përpara ndeshjes së parë.

Broja refuzon transferimin në Turqi

Londër, 13 dhjetor - Armando Broja duket se do të largohet nga Chelsea gjatë afatit kalimtar të janarit për të gjetur një skuadër të re ku do të jetë një titullar i padiskutueshëm. Ylli shqiptar së fundmi ishte titullar në sfidën ndaj Evertonit duke luajtur për 67

minuta, por pa arritur të lë gjurmë pasi Chelsea u mposht 2-0. Pavarësisht dëmtimit të rëndë që pati dhe që e mbajti jashtë fushave për rreth një vit, shqiptari po mundohet të rikthehet në formën më të mirë të mundshme. Emri i tij ka qarkulluar shumë në

mediat e huaja pasi është në radarët e shumë ekipeve si në Ligën Premier ashtu edhe jashtë vendit. Megjithatë Fabrizioo Romano ka raportuar se sulmuesi shqiptar i ka thënë jo transferimit në Superligën e Turqisë, pavarësisht interesimit të shumë klubeve

turke. Qëllimi i shqiptarit është që të mbetet në Ligën Premier edhe nëse jo te Chelsea atëherë te ndonjë skuadër tjetër. West Ham United dhe Fulham janë dy klubet angleze që kanë shprehur interesimin më të madh për transferimin e shqiptarit në janar.



TKZ bëjnë gati një festë të madhe për 20-vjetor: Ejani të gjithë në 'Sheshin Skënderbej'

Tiranë, 13 dhjetor - Tifozat Kuq e Zi festojnë 20-vjetorin e themelimit në datën 23 dhjetor. Grupimi më i madh që mbështet kombëtaren shqiptare dhe këdo që nderon dhe lartëson flamurin kuqezi, do të bëjë një festë të jashtëzakonshme. Me anë të një postimi në faqen zyrtare, TKZ, që prej dy dekadash ndjek skuadrën kombëtare në çdo ndeshje, theksojnë se këtë vit festa do të jetë edhe më e madhe edhe për shkak të kualifikimit në "Euro 2024". Në lajmërim theksohet se kremtimi madhështor do të organizohet të shtunën e 23 dhjetorit në "Sheshin Skënderbej". Duke nisur prej orës 18:00. "20 vjet TKZ është një rrugëtim i gjatë. Në çdo stadium shqiptar dhe të huaj ku kemi shkuar, ne kemi qenë aty për dhe me Kombëtaren tonë. Ndërkohë që Kombëtarja është rritur profesionalisht dhe sapo e ka siguruar kualifikimin e saj të dytë në Kampionatin Evropian të Futbollit. Edhe ne, Tifozat Kuq e Zi, jemi rritur. Misioni ynë i përhershëm është që ne të jemi gjithmonë të pranishëm aty ku luan ekipi ynë kombëtar. Me një



përkrahje të fortë dhe të palëkundur. Pavarësisht nëse luan kundër një ekipi të madh apo të vogël në emër. Dhe pa marrë parasysh nëse loja luhet larg apo afër. Në shi apo në diell, me fitore apo me humbje, ne kemi qenë gjithmonë aty. Në mbështetje të ngjyrave kuq e zi. Kudo ku është ngritur flamuri ynë kombëtar, aty kemi qenë të pranishëm ne. Tifozat Kuq e Zi, të rreshtuar pas banerit tonë "TIFOZAT KUQ E ZI" dhe "O SA MIRË ME QENË SHQIPTAR!", thuhet në njoftimin e tifozëve kuqezi. "Ky 20-vjetor i themelimit të grupimit tonë përkon edhe me

kualifikimin e Kombëtares sonë të Futbollit në Kampionatin 'Euro 2024'. Dhe për rrjedhojë festa jonë këtë fundvit bëhet edhe më e madhe. Kremtimi madhështor do të organizohet ditën e shtunë, datë 23 dhjetor 2023, në orën 18:00, në 'Sheshin Skënderbej', në Tiranë. Festa është e hapur për të gjithë, si për anëtarët aktivë dhe anëtarët ndër vite të TKZ-së, ashtu edhe për çdo shqiptar. Që, me zemër, e dëshiron bashkimin e të gjithë shqiptarëve anembanë botës përreth një ekipi të vetëm kombëtar", thuhet ndër të tjera në njoftimin e TKZ-së.

Denveri kalon krizën, humbasin Lakersat, Bostoni rimerr kreun në Lindje

ATLANTA, 12 DHJETOR - Philadelphia qëndron në grupin e skuadrave pretendente në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 146-141 ndaj Washingtonit në një ndeshje spektakolare. Joel Embiid me 34 pikë e 11 rebounde ishte shënuesi më i mirë i ndeshjes. Fituan edhe kampionët e Denverit, që mposhtën me rezultat 129-121 Atlantën jashtë fushës, ndeshje ku Murray e Jokiq realizuan 54 pikë së bashku. Skuadra e Dallasit, falë 35 pikëve të Donqijit, mundi Memphisin (120-113), duke korrur një fitore të madhe jashtë fushës. Minnesota ruan kreun e renditjes në Perëndim pavarësisht humbjes 121-107 në fushën e New



Orleansit. Për vendasit u dallua Zion Williamson, autor i 36 pikëve. Fitoi skuadra e Miamit, që falë 24 pikëve të Robinsonit dhe 23 të Butlerit, mundi me rezultat 116-114 Charlotten. Ekipi i Clippersit mposhti me rezultat 132-127

Portlandin, ndeshje ku dallimin e bëri Leonardo me 34 pikë. Moment të mirë po kalon Oklahoma, në vendin e dytë në Perëndim, duke fituar me shifrat 134-120 ndaj Utah Jazzit, sfidë ku u dallua Shai me 30 pikë.

SHKURT

Ronaldo: Më vjen keq që nuk erdha më herët tek Al Nassr

Futbollisti portugez dhe lojtari i Al Nassr, Cristiano Ronaldo, tha se është penduar që nuk erdhi më herët në klubin saudit. Ronaldo u transferua nga Manchester United tek Al Nassr në fund të vitit të kaluar dhe deri tani ka shënuar 40 gola. Hera e fundit kur shënoi ishte së fundmi në ndeshjen çerekfinale të Kupës së Arabisë Saudite kundër Al Shabaab. "Jam shumë i lumtur që luaj për Al Nasr dhe mezi pres të vazhdoj të luaj për këtë klub të madh. Më vjen shumë keq që nuk kam ardhur më herët, por tani jam këtu dhe do të mundohem ta ndihmoj skuadrën të arrijë suksese", ka thënë Ronaldo.

Ramosi thyen një rekord të madh në Ligën e Kampionëve

Sevilla është eliminuar nga Liga e Kampionëve pas humbjes që pësoi 2-1 në udhëtim te Lensi. Por këtë ndeshje Sergio Ramos do ta mbajë gjatë në mendjen e tij, pasi ka arritur të thyej një rekord të madh në garën më të madhe evropiane për klube, Ligën e Kampionëve. Qendërmbrojtësi spanjoll shënoi me një penallti të ekzekutuar me "Panenka" në këtë sfidë golin e vetëm të skuadrës së tij dhe u bë mbrojtësi me më shumë gola në historinë e Ligës së Kampionëve. Rekordi i mëparshëm ndahej mes tij, Gerard Piques dhe Roberto Carlosit me nga 16 gola, derisa tani Ramos është i vetëm në krye me 17 gola të realizuara. Ky ishte goli i 138 në karrierë në ndeshje zyrtare për Sergio Ramos, një shifër e pabesueshme duke pasur parasysh që ai është qendërmbrojtës. Spanjollit konfirmohet si thuasje i pagabueshëm në gjuajtjet e penalltive, teksa ka realizuar 28 nga 30 të fundit që ka gjuajtur. Ndërkohë, ka gabuar vetëm një herë nga 12 penalltitë që i ka ekzekutuar në stilin "Panenka".

Chiellini pensionohet zyrtarisht nga futbolli aktiv

Futbollisti italian, Giorgio Chiellini ka njoftuar se i ka dhënë fund karrierës së tij si lojtar. Chiellini i dha lamtumirën futbollit pasi pak ditë më parë me Los Angelesin u mposht në finalen e "play-off"-it të MLS nga Columbus (1-2). "Ishe udhëtimi më i bukur dhe më intensiv në jetën time. Ti ishe gjithçka për mua. Kam kaluar një udhëtim unik dhe të paharrueshëm me ju. Ka ardhur koha për të filluar një kapitull të ri, për t'u përballur me sfida të reja dhe për të shkruar faqe të rëndësishme dhe emocionuese të jetës", ka shkruar Chiellini në rrjetet sociale. Përpara Los Angelosit, Chiellini ka luajtur për Fiorentinën, Juventusin, Livornon dhe Romën. Ai kaloi nëpër të gjitha përzgjedhjet e të rinjve të Italisë dhe luajti për ekipin A të Azzurrëve nga viti 2004 deri në vitin 2022. Chiellini luajti 117 ndeshje për Italinë dhe shënoi tetë gola dhe me kombëtaren fitoi Kampionatin Evropian, i cili u mbajti në vitin 2021.

Futbolli turk do të rikthehet javën tjetër

Futbolli turk do të rikthehet javën tjetër me ndeshjet e ligës elitare që do të zhvillohen të martën. Krejt ligat turke u pezulluan për afat të pacaktuar pas sulmit në

fushën e blertë që e bëri presidenti i klubit ndaj gjyqtarit, i cili përfundoi në spital me sy të ënjtur dhe me lëndime trupore, raporton "Reuters". Të hënën mbrëma,

në fund të ndeshjes së Super Lig, presidenti i Ankaragucu, Faruk Koca hyri në fushë nga tribunat dhe e grushtoi në fytyrë gjyqtarin Halil Umut Meler. Ky i fundit përfundoi i

shtrirë në tokë, ndërsa u godit me shqelma në kokë dhe në trup nga zyrtarët tjerë të klubit. Koca u arrestua të nesërmen bashkë me dy zyrtarë të klubit dhe Federata e

suspendoi krejt futbollin turk. E sot, presidenti i Federatës Turke të Futbollit, Mehmet Buyukeksi njoftoi se futbolli në këtë vend do të rikthehet më 19 dhjetor.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 13.12.2023, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Punëtorë Fizik 16 pozita (8 Pozita vendi i punës Pejë, 8 Pozita vendi i punës Klinë)

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Punëtori Fizi ka këto detyra dhe përgjegjësi

- 1.Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
- 2.Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- 3.Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
- 4.Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
5. Kryen edhe punë tjera me urdhëres Shoferit, Kryepunëtorit
6. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Shoferit, Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives, Kyeshefit Ekzekutiv

Kushtet:

- Shkollimi fillore
- Aftësi fizike dhe psikike të deshmuar
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Pozita : ARKATAR / E

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

- 1.Pranon pagesat në të gatshme dhe plotëson fletëpagesën në tri kopje, kopjen e pare ia dorëzon pales.
- 2.Furnizon -tërheq dhe jep triskat për lëndë djegëse dhe evidencën e tyre.
- 3.Udhëheqë ditarin e arkës veçmas për karburante.
- 4.Të hyrat e gatshme i dorëzon në bankë-xhiro llogarin e Ndërmarrjes, pa vonesë.
- 5.Përpilon ditarin e arkës për çdo ditë mbi të hyrat dhe të dalurat dhe ia
- 6.bashkangjet dokumentacionin në gjendje të rregullt, i verifikuar nga personat e autorizuar.
- 7.Çdo pagesë në favor apo barrë në të gatshme e evidenton në urdhëresat "inkasoni-paguani"
- 8.Është i obliguar që t'i përmbahet maksimumit të mjeteve finansiare të arkës për të cilin bjen vendim organi kompetent.
- 9.Çdo ditë i raporton Përgjegjësit financiar të shërbimit për gjendjen në arkë.
- 10.Llogarit të ardhurat personale dhe karnetat e të ardhurave i dorëzon në bankë

- 11.Mban përgjegjësi për pagesën e dokumenteve të cilat nuk janë të vërtetuara nga personat e autorizuar, që janë në kundërshtim me ligjin.
- 12.Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Përgjegjësit financiar, Kryeshefit Ekzekutiv
- 13.Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv

Kushtet:

- Shkolla e mesme ekonomike, përparësi Diplome Universitare
- 1 vite përvojë pune.
- njohja e punës me kompjuter.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Pozita : 5 Pozita VOZITËS- / I AUTOMJETEVE PËR BARTJEN E HEDHURINAVE
(4 shofer vendi i punës Pejë dhe 1 shofer vendi i punës Istog)

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

- 1.Drejton automjetin, kujdeset për rregullsin e tij dhe është përgjegjës për vozitjen e sigurt, duke i respektuar rregullat e komunikacionit.
- 2.Kujdeset për higjienën dhe pastërtin e automjetit, pas kryerjes së punës bënë larjen e automjetit.
- 3.Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga Kryepunëtori në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve
- 4.Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatën për fikjen zjarrit dhe paisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion.
- 5.Me rastin e prishjes së automjetit vozitësi është i obliguar të bënë ndreqje të vogla, si nderimin e gomës, pastrimin e filterit etj. të qëndroi pran automjetit në punëtor dhe ti ndihmoimekanikut ose gomistit.
- 6.Çdo mëngjez është i obliguar të kontrolloi sasinë e vajit, ujit dhe gjendjen e gomave në makinë.
- 7.Është i obliguar që për prishjet në automjet me kohë të lajmëroi kryepunëtorin e vet drejtëpërdrejt.
- 8.Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit apo Menaxherit të Operatives.
- 9.Është i obliguar të menaxhoi dhe të mbaj nën kontroll ekipin e punetoreve fizik.
10. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives
11. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives, Kyeshefit Ekzekutiv

Kushtet:

- Shkollimin e mesem
- Përgaditje profesionale-voztësi kategorive përkatëse (c)
- 2 (dy) vite përvojë pune.
- Aftësi fizike dhe psikike të deshmuar
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 29.12..2023 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë

Bazuar në dispozitat e nenit 21, nenit 25, par. 25.2, pika h, e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/2008 (dt. 15.06.2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/2021 (dt. 30.05.2012), dhe Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe Udhzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komisioni i Auditimit të KRM "Uniteti", Sh.A – Mitrovicë, vendosi që të rishpallë këtë:

KONKURS

Pozita: Auditor i Brendshëm

I përgjigjet: Komisionit të Auditimit

Vendi: Mitrovicë

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit;
- Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të auditimit të brendshëm për të gjitha transaksionet e NP, konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të NP, të bazuara në Ligjin e aplikueshëm;
- Auditimi i planeve investive dhe financiare të NP, planit vjetor të biznesit dhe buxhetit vjetor;
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj;
- Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të NP si dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit;
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP, të gjitha Ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe t'i siguroj Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje apo sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme;
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP, duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me Ligjin dhe që projekt deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt;
- Analiza e sistemeve dhe proceseve të biznesit dhe kontroleve të ndërlydhura me to;
- Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përmbushja e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit;
- Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe po ashtu secili kandidatë duhet të përmbushë të gjitha kushtet e pavarësisë ashtu sikurse parashihet në nenin 17.2 (d), (f), (j), (k), (l) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkua:

- Të ketë Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet;
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në lëmitë e Auditimit të Brendshëm, Kontrollës së Brendshme dhe/apo Financave dhe Kontabilitetit;
- Të jetë i certifikuar si auditor i brendshëm nga institucionet e licencuara në vend ose jashtë tij;

Njohurit dhe shkathtësitë profesionale

- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Njohuri e Ligjeve, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme;
- Shkathtësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes të aktiviteteve të auditimit;
- Shkathtësi humluese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi organizative në përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve me qëllim të realizimit të tyre në kohë;
- Shkathtësi kompjuterike në programet, Microsoft Word, Excel dhe Access;
- Njohja e gjuhës angleze është e preferueshme.

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Certifikatën për Auditor të Brendshëm,
- Referencat, si dhe certifikatat tjera profesionale,
- Letër Motivimin,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Kopja e dokumentit të identifikimit.

